



# SIKA AT WORK

## BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE, PRISHTINË, KOSOVË

RIPARIM DHE HIDROIZOLIM ÇATIE: Sikalastic®

BUILDING TRUST



# BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE, PRISHTINË, KOSOVË

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës është themeluar nga Kuvendi i Kosovës dhe ka për qëllim kryesor mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e trashëgimisë intelektuale të Kosovës.

E ndërtuar në vitin 1974 dhe e dizajnuar nga arkitekti kroat Andrija Mutnjakovic, biblioteka si tërësi arkitekturore paraqet një kombinim të kubeve dhe kupolave dhe i takon tipit të arkitekturës të "regionalizmit të ri". Ndërtesa është katërkateshe me sipërfaqe prej 16.500 m<sup>2</sup>, prej të cilave 13.500 m<sup>2</sup> sipërfaqe të shfrytëzueshme. Në pikëpamjen kompozicionale biblioteka veçohet si tërësi kubesh të mbështjella me membranë skeletore çeliku, e cila në kombinim me ndriçimin zenitor të realizuar përmes kupolave, krijon një sistem ndriçimi që siguron ndriçim të bollshëm dhe mbrojtje nga izolimi i tepruar. Gjithsej janë 99 kupola të ndara me segmente që i përngjajnë trurit dhe simbolikisht paraqesin dijen.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës është gjithashtu një monument nën mbrojtje të trashëgimisë kulturore në kategorinë "Arkitekturor" i miratuar me numër 3639.

## KËRKESAT E PROJEKTIT

Duke qenë se kanë kaluar më shumë se 40 vite nga ndërtimi dhe vënia në funksion e objektit, ishte i nevojshëm restaurimi i plotë i çatisë së tij.

Çatia ka qenë e hidroizoluar me shirita bituminoz, por me kalimin e kohës në disa vende të caktuara ka filluar rrjedhja dhe si pasojë ishte i nevojshëm demolimi i të gjitha shtresave ekzistuese hidro dhe termoizoluese deri te pllaka konstruktive betonarme dhe punimi nga e para i hidro dhe termoizolimit të çatisë me këtë renditje:

1. Shtresa kundër avullit
2. Termoizolim 10 cm PIR ose XPS
3. Shtrese betoni për rrafshim dhe me pjerrësi për largimin e ujit
4. Hidroizolimi i të gjithë sipërfaqes me membranë të lëngshme

Të gjitha punimet janë realizuar gjatë vitit 2020.




## ZGJIDHJA NGA SIKA

Duke analizuar kërkesat e projektit, Sika propozoi zgjidhjen e mëposhtme:

- Për përgatitjen e shtresës për rrafshimin e betonit u sugjerua hedhja e fibrave polipropileni SikaFiber® P/P 6mm dhe 12mm të cilat ulin mundësinë e plasaritjeve dhe përmirësojnë rezistencën e saj.
- Shtresa me bazë polietileni Sarnavap®-1000 E, e cila përdoret edhe për çatitë e pjerrëta. Kjo shtresë u aplikua me shtrim të lirë mbi të gjithë sipërfaqen që do të hidroizolohej dhe ofron fleksibilitet në temperatura të ulëta dhe rezistencë ndaj depërtimit të avujve të ujit. Të gjitha mbivendosjet e saj u izoluan me shiritin prej gome butili Sarnavap® Tape F.
- Përpara aplikimit të membranës së lëngshme mbi nënshtresën e betonit u aplikua Sika® Concrete Primer, një prajmer poliureje me 2 përbërës i cili stabilizon nënshtresën dhe ofron ngjitje të mirë të membranës së lëngshme.
- Ndërsa përpara aplikimit të membranës së lëngshme mbi sipërfaqet metalike dhe bituminoze të objektit, u përdor prajmeri epoksid me 2 përbërës Sikalastic® Metal Primer.
- Hidroizolimi vijoi me membranën e lëngshme prej poliuretani me 1 përbërës dhe tharje të shpejtë Sikalastic®-614, e cila është e përshtatshme për projekte restaurimi. Sikalastic®-614 aplikohet me metodën e ftohtë dhe ngjitet mirë mbi shumë nënshtresa duke ruajtur elasticitetin e saj në temperatura të ulëta. Çatia e projektit në fjalë kishte detaje shumë komplekse të cilat përforcuan me rjetën prej fibrash qelqi Sika® Reemat Premium, në 2 shtresa me konsum total 2.5 kg/m<sup>2</sup>.
- Pas tharjes së plotë të shtresës së parë, vijoi aplikimi i shtresës përfundimtare të Sikalastic®-614 me konsum ~ 300 gr/m<sup>2</sup> e ngopur me rërë kuarci me granulometri 0.3-0.8 mm.





#### SASIA E PRODUKTEVE SIKA

- Sarnavap® Tape F: 2,200 m
- Sarnavap®-1000 E: 2,150 m<sup>2</sup>
- Sika® Concrete Primer: 850 kg
- Sikalastic®-614: 8,200 kg
- Sikalastic® Metal Primer: 500 kg
- Sika® Reemat Premium: 3,500 m<sup>2</sup>
- Rërë kuarci 0,3-0,8 mm: 7,500 kg
- SikaFiber® PP 6mm, 12mm: 80 qese

#### PJESËMARRËSIT NË PROJEKT

**Investitor:** Qeveria e Kosovës, MKRS

**Kontraktori kryesor:** K-ING SHPK, Prishtinë

**Distributor:** A&F Construction SHPK, Prishtinë

#### Sika Albania SHPK

Rinas Road, Tirana Business Park,  
Building no.7, 4-th floor  
Tirana, Albania

#### Contact

Phone: +355 4 454 0070  
Email: info@al.sika.com  
Website: alb.sika.com

**BUILDING TRUST**

